



## Zbuloni gjuhën tuaj të dashurisë Pyetsori për burrat



Ndoshta mendon se e dini gjuhën tuaj parësore të dashurisë, por ndodh që mund të mos e keni idenë fare. Pyetsori do t'ju ndihmojë të zbuloni se cila gjuhë, është gjuha juaj e dashurisë Fjalët Përgëzuese, Koha Cilësore, Dhuratat, Veprat e Shërbimit apo Prekja Fizike. Pyetsori përbëhet nga 20 grupe thëniesh. Mund të zgjidhni vetëm një të pikë në secilin grupim. Lexoni secilin grupim dhe në kolonën në të djathtë, rrethoni gërmën që përputhet me thënien që zgjidhni. Ndonjëherë mund të jetë e vështirë për të vendosur midis dy mundësive, por duhet të zgjidhni vetëm një për rezultate të sakta të pyetsorit.

Merrni 20—30 minuta kohë për të plotësuar pyetsorin. Pasi të keni rrethuar zgjedhjen tuaj numëroni sa herë keni rrethuar secilën gërmë. Në fund të pyetsorit shkruani numrin që tregon sa herë e keni rrethuar atë gërmë.

### 1. Do të ndjehem më i dashuruar nëse:

- Gruaja do të më shkruantë një kartolinë dashurie A
- Gruaja do të më jepte një përqaftim B
- Gruaja do të më ndihmonte në punën që kam për të bërë D

### 2. Më pëlqen:

- Nëse kaloj kohë vetëm me gruan B
- Nëse marr dhurata prej saj C
- Nëse gruaja më përkëdhel E

### 3. Do të ndjehem më i dashuruar nëse:

- Gruaja më surprizon me dhurata C
- Gruaja më lan rrobat D
- Gruaja do të futi krahun kur ecim së bashku E

### 4. Më pëlqen nëse:

- Do të shkoja në udhëtime të gjata me gruan B
- Kapem dorë për dore me gruan E
- Dëgjoj gruan të më thotë se më do A

### 5. Më pëlqen nëse:

- Dal me gruan pavarësisht se ku shkojmë B
- Marr dhurata C
- Gruaja ulet pranë meje E

6. Më pëlqen nëse:

- Gruaja më thotë se dukem mirë A
- Pimë kafën bashkë të dy B
- Gruaja më gatuan D

7. Zgjidh njëriën:

- Gjëra të vogla që gruaja ime do të bënte për mua janë shumë domethënëse dhe me vlerë C
- Do të më pëlqente ta përqafoja gruan time E
- Do të kishte shumë vlerë për mua nëse gruaja më jep dhurata që më pëlqejnë shumë C

8. Janë të rëndësishme për mua:

- Edhe dhuratat më të vogla prej gruas C
- Pavarësisht se çfarë gjërash bëjmë t'i bëjmë bashkë B
- Komentet inkurajuese prej gruas sime A

9. Më pëlqen nëse:

- Gruaja më thotë që është krenare për mua A
- Të jem pranë gruas sime B
- Kur gruaja më fërkon kurrizin E

10. Vlerësoj shumë nëse:

- Gruaja do të shpreh vlerësimin për arritjet e mia A
- Gruaja do të më ndihmojë me diçka që e di se ajo e urren D
- Gruaja ime do të tregoj interes në gjërat që mua më pëlqejnë të bëj B

11. Kurrë nuk lodhem:

- Nëse gruaja do të më bëj komplimenta A
- Nga puthjet e gruas sime E
- Nëse do të hap dhurata nga gruaja ime C

12. Më pëlqen nëse:

- Gruaja do të më ndihmojë me projekte që kam për të bërë D
- Gruaja do më bëjë komplimenta për paraqitjen A
- Gruaja do të më dëgjonte idetë dhe nuk do të nxitonte të më gjykonte ose kritikonte B

13. Zgjidh njëriën nga të treja:

- Do të më pëlqente ta ledhatoja gruan kur është pranë E
- E vlerësoj nëse gruaja do të shkoj të bëj pagesat e faturave të ndryshme (ujit, energjisë, pazaret, etj) D

- Do të vlerësoja shumë nëse gruaja do të më përgatiste një dhuratë të veçantë për Krishtlindje C

14. Do të doja të:

- Kisha vëmendjen e pandarë të gruas sime B
- Të merrja dhurata për ditëlindjen nga gruaja ime C
- Të kisha ndihmën e gruas kur kam nevojë D

15. Do të vlerësoja nëse:

- Do të dëgjoja që jam i rëndësishëm për gruan time A
- Gruaja do të më tregonte se më donte duke më dhënë dhurata C
- Gruaja e mbante pastër shtëpinë D

16. Më pëlqen nëse:

- Gruaja do të më tregonte dashuri duke më ndihmuar me punë që kam për të bërë në shtëpi D
- Gruaja nuk do të më ndërpriste kur flas B
- Do të merrja dhurata prej gruas C

17. Më pëlqen:

- Pavarësisht se ku shkoj të jem me gruan time B
- Nëse do të kryej marrdhënie seksuale me gruan E
- Nëse do të marr dhurata surprizë C

18. Do të doja:

- Të dëgjoja fjalë inkurajuese nga gruaja që do të më bënin të kisha vetbesim A
- Do të doja të shikonim film së bashku B
- Do të doja të merrja dhurata prej gruas që tregojnë përkushtimin nga ana e saj C

19. Do të doja:

- Që gruaja të më pyeste si mund të më ndihmoj kur unë jam i lodhur D
- Që gruaja të më thoshte që më vlerësonte sepse kjo më bën të ndjehem mirë A
- Që gruaja të më përkëdhelte E

20. Më pëlqen nëse:

- Gruaja do të më puthë dhe përqafojë pasi të kemi qënë të ndarë për një kohë E
- Do të dëgjoja gruan të thoshte që ka besim tek unë A
- Gruaja do të më ndihmonte pavarësisht se ka gjëra të tjera për të bërë D

A=Fjalët Përgëzuese \_\_\_\_\_

B=Koha Cilësore \_\_\_\_\_

C=Dhuratat \_\_\_\_\_

D=Veprat e Shërbimit \_\_\_\_\_

E=Prekja Fizike \_\_\_\_\_

### **Interpretimi dhe përdorimi i pikëve të pyetsorit**

Gjuha juaj parësore e dashurisë është ajo e cila ka numrin më të lartë të pikëve. Zotëroni dy gjuhë nëse rezultati juaj më i lartë i pikëve është i barabartë për dy gjuhë. Kur një gjuhë e dashurisë e cila ka një numër pikësh të përafërt por jo të barabartë me gjuhën e parë të dashurisë, do të thotë se të dyja format e shprehjes së dashurisë janë të rëndësishme për ju.

Mund të keni marrë më shumë pikë në disa prej gjuhëve të dashurisë në krahasim me të tjerat, por mos i trajtoni si të parëndësishme këto gjuhë të tjera. Gruaja juaj mund të shprehë dashurinë në ato gjuhë, dhe kjo do t'ju ndihmojë ju ta kuptoni atë.

Në të njëjtën mënyrë, do të jetë e dobishme për gruan tuaj të dijë gjuhën tuaj të dashurisë dhe ta shprehë dashurinë për ju në mënyra që ju i kuptoni si dashuri. Sa herë që ju ose gruaja juaj flisni gjuhën e dashurisë së personit tjetër, ju fitoni pikë emocionale me njëri—tjetrin. Ajo që fitoni kur flisni gjuhën e dashurisë së njëri—tjetrit është një ndjesi lidhjeje më e ngushtë. E thënë ndryshe, është komunikim më i mirë, më shumë mirëkuptim, dhe përfundimisht një romancë edhe më e mirë

